



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Komisionit për hartimin e Udhërrëfyesit për Planet rregulluese

Prishtinë, 03 gusht 2011

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bazë të vendimit të Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor të marrë në takimin me 08 qershor 2011 organizoj takimin e Komisionit për hartimin e Udhërrëfyesit për Plane rregulluese.

Në takim morën pjesë:

- Elida Bejtullahu – Udhëheqëse e Drejtorisë për Urbanizëm, Komuna e Gjakovës
- Shpresa Osmanollaj – Bashkëpunëtoare Profesionale, Komuna e Prizrenit
- Fadil Sherifi – Shef i SPMM, Komuna e Gjilanit
- Modest Gashi – Udhëheqës i DUMM, Komuna e Pejës
- Arbnesha Kryeziu Goga – Urbaniste, Komuna e Pejës
- Florije Berisha – Juriste DUMM, Komuna e Pejës
- Gloriosa Hisari – Zyrtare ligjore, UN Habitat
- Lumnije Gashi – Planer Hapësinor, UN Habitat
- Ertan Munoglu – Menaxher Programi, AKK

Në takim mungoi anëtarja e Komisionit Hasie Dushi nga Komuna e Obiliqit.

PËRMBLEDHJE

➤ Themelimi, përbërja dhe qëllimi i Komisionit

Vendimin për themelimin e këtij Komisioni është marrë nga Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor në takimin e datës 08 qershor 2011.

Përbërja e Komisionit është si në vijim:

1. Elida Bejtullahu – Udhëheqëse e Drejtorisë për Urbanizëm, Komuna e Gjakovës
2. Shpresa Osmanollaj – Bashkëpunëtoresh Profesionale, Komuna e Prizrenit
3. Fadil Sherifi – Shef i SPMM, Komuna e Gjilanit
4. Modest Gashi – Udhëheqës i DUMM, Komuna e Pejës
5. Hasie Dushi - Komuna e Obiliqit

Komisioni do të përkrahet me asistencë profesionale nga UN Habitat. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe akterë tjerë relevant mund të ftohen sipas nevojës.

Qëllimi i këtij Komisioni është të hartoj një Udhërrëfyes i cili do të ndihmonte komunat e Kosovës në planifikimin dhe zbatimin e Planeve rregulluese. Ky Udhërrëfyes nuk mendohet të jetë akt normativ, por më shumë një dokument i cili do të lehtësojë punën e komunave.

➤ Përmbajtja e Udhërrëfyesit

Në takim u diskutua rreth përmbajtjes së Udhërrëfyesit, gjë që për momentin është e paqartë dhe ka nevojë për t'u definuar më saktësisht. Udhërrëfyesi mund të përmbajë elemente me të cilat komunat ballafaqohen vazhdimisht gjatë planifikimit si dhe gjatë zbatimit të planeve rregulluese, e këto mund të janë:

- Objektivat dhe aktivitetet
- Infrastruktura ligjore dhe pengesat që derivojnë nga legjislacioni. A ka nevojë për një interpretim më të thukët?
- Aspektet organizative – stafi komunal dhe stafi i kompanive që hartojnë planet
- Çfarë është përmbajtja e Planeve rregulluese dhe si mund të përmirësohet?
- Procesi për hartimin dhe zbatimin e planeve rregulluese – analiza e pesë fazave
- Pyetësi për konsultim me qytetarët – Edhe pse me pyetësorë merret kompania e cila zhvillon planin zhvillimor, komuna duhet të sigurohet që pyetësi adreson çështjet kyçe për një plan të caktuar. Duke marrë parasysh se pyetësorët nuk mund të jenë uniform për të gjitha planet, ndoshta Udhërrëfyesi mund të përfshijë disa kriterë bazë, të domosdoshme për çdo plan?
- Transparenca – a ka mekanizma të mjaftueshëm për konsultim me qytetarë
- Sipërfaqja e Planeve rregulluese – cila është sipërfaqja optimale për një plan?

- Identifikimi i grupeve punuese
- Konflikti i interesit – kush duhet të bëjë planet, kush të lëshoj leje e kush të bëjë zbatimin?
- Riparcelizimi - a është kjo procedurë e qartë dhe e rregulluar sa duhet?

Udhërrëfyesi mund të nxjerr mësimë edhe nga përvoja e shteteve të rajonit. UN Habitat-i ka marrë përsipër përgatitjen e një drafti fillestar të përmbajtjes së Udhërrëfyesit, të cilën do ta shpërndanë tek të gjithë anëtarët e Komisionit për komente, dhe e cila do të shërbejë si bazë për hartimin e Udhërrëfyesit.

➤ **Organizimi i punës së Komisionit**

Pasi që ky ishte takimi i parë dhe ka shumë paqartësi rreth përmbajtjes së Udhërrëfyesit, anëtarët u dakorduan për hapat si në vijim:

1. Anëtarët e Komisionit do të shfrytëzojnë muajin gusht për të komentuar në draftin që do ta përgatis UN Habitat-i
2. Komisioni do të takohet në fillim të shtatorit për të definuar strukturën e dokumentit
3. Në këtë takim Komisioni do të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së punëve në mes anëtarëve
4. Po ashtu në këtë takim Komisioni mund të përpiloj një plan përkatës të punës ku do të definohet dinamika e punës, përfshirë llojin dhe mënyrën e takimeve.

Komisioni do këshillohet rreth Udhërrëfyesit edhe me akterë tjerë relevant si p.sh. Ministrinë relevante, kompanitë, Drejtorët dhe stafin përkatës komunal, etj.

➤ **Raportimi**

Komisioni do t'i raportoj rregullisht Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor përmes raporteve të shkruara të takimeve të Komisionit, shpërndarjes së drafteve të Udhërrëfyesit dhe gjatë takimeve të Kolegjiumit.

KONKLuzionet

- UN Habitat-i të përgatis draftin fillestar të përmbajtjes së Udhërrëfyesit
- Në takimi në dytë në fillim të shtatorit, Komisioni të definoj përmbajtjen e Udhërrëfyesit dhe të planifikoj punën e vet deri në përfundim të Udhërrëfyesit
- Anëtarët të japin propozimet edhe në bazë të njohurive që kanë nga shtetet e rajonit
- Akterët tjerë relevant të konsultohen dhe ftohen në takimet e Komisionit sipas nevojës
- Komisioni t'i raportoj rregullisht Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor